

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Durrësi mirëpret festivalin folklorik, grupe nga disa vende interpretojnë këngët e vallet tradicionale – Vizi on Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/durresi-mirepret-festivalin-folklorik-grupe-nga-disa-vende-int-erpretojne-kenget-e-vallet-tradicionale/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 23:33:28 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	1 shtator 2026, 09:44:03 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	fe8ed0dfd8beee5aa21b8a50af1e235f095f74c105cd6ce4e136313385003bc3
TEKSTI	d68e5f58e8fc5266462ff0b1251b54cef74d23a74d74fd1a7fa83dfd489d695a
PAMJA	086a086e4e0d4f30653adb556e1e5f62515fff68ecc8cc836cb0e3dd60b17a9ae

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ddd2946432f6414b2c9983bfb43f9af55340bec7208054df5bda1f171ef1bb97
E MËPARSHMJA	f828faa21fbc1635f4e2c9b91c95ad3b88d0a354366e5b3424a4327a5f516eba
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ddd2946432f6414b2c9983bfb43f9af55340bec7208054df5bda1f171ef1bb97>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Bulevardi "Epidamn" u pushtua nga veshjet tradicionale popullore të grupeve nga Shqipëria, Bullgaria, Rumania dhe Izraeli, të cilët pas paradës në qytet u ngjitën në skenë për të përcjellë për publikun më të mirën e këngëve dhe valleve tradicionale të vendeve të tyre.

Risia e mbrëmjes së djeshme ishte një grup kërcimi nga Izraeli, i cili përbëhej nga valltarë të zakonshëm si dhe 6 persona me aftësi të kufizuar, të cilët e realizuan shfaqjen e tyre në karrige me rrota.

Koreografi i këtij grupi Romi Siman tha se vijnë në Durrës me një koreografi speciale:

"Ne vijmë për herë të parë në Durrës dhe kemi një grup shumë special për këtë shfaqje, pasi në përbërje kemi edhe persona me aftësi të kufizuar që do të performojnë në karrige me rrota. Shqipëria është një vend shumë i bukur dhe na pëlqen shumë mirësjellja e shqiptarëve. Falenderojmë organizatorët që na ftuan në këtë festival", tha Romi Siman, koreograf grupi nga Izraeli

Me këto shfaqje, qyteti bregdetar është kthyer kështu në një skenë të madhe të kulturës dhe traditës dhe në një pikëtakim të kulturave të ndryshme. Përmes këtyre aktiviteteve synohet forcimi i miqësisë dhe mirëkuptimit mes popujve, duke bashkuar në të njëjtën skenë grupe folklorike, kore, banda frymore, orkestra dhe artistë të zhanreve të ndryshme të vallëzimit.

#durrës

#festivalifolklorik

3 Begaj uron nisjen e vitit të ri shkollor.
Besoni te vetja dhe tek ëndrrat,...

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

emaili juaj

Abonohu



Redaksia Web

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

Më shumë video



VIDEO

Gjashtë shekuj në një dokumentar! "Përtej..."

Xhuljana
Zhuleku

Dje
15:40




VIDEO

Zanatet tradicionale po harrohen, mjesht...

Xhuljana
Zhuleku

Dje
14:10



VIDEO

Lajm i mirë, Gonxhja: Dea e Butrintit...

Taulant Halili · 11 Sht



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE



Lajme

Politikë

Bota

Vendi

Kronikë

Lifestyle

Programe

Programe

Seriale

Guida TV

Video

Ekipi i Vizion Plus

Rrjeti

Rreth nesh

Karriera

Kontakt

Reklamo me ne

Dërgo lajmin tënd

Ligjore

Kushtet e përdorimit

Privatësia

Cookies

Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv

Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.